



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2015

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Edh gjatë vitit 2015, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka punuar në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të komunave, ofrimit të shërbimeve të avancuara dhe përmirësimit të performancës së komunave, konsolidimit dhe fuqizimit të strukturave të reja të AKK-së dhe performancës së mirë financiare. Këto aktivitete janë të bazuara në Planin Strategjik të AKK-së për vitin 2011-2015, Planin Vjetor 2015 si dhe prioritetet e përcaktuara nga strukturat udhëheqëse.

Në këtë periudhë lobimi, AKK-ja ka qenë e përqendruar në: (i) Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (ii) Ligjin për partneritetin publiko-privat, (iii) Ligjin për pyjet, (iv) Ligjin për tatimin në pronë, (v) Ligjin për pagat dhe (vii) Ligji për barazi gjinore. Në të njëjtën kohë, AKK-ja ka konsoliduar qëndrimet për çështjet tjera (vii) Katalogu i vendeve të punës, (vii) falja e borxheve për disa kompani publike. Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave morën pjesë në Këshillin Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik ku i prezantuan qëndrimet e komunave të Kosovës.

Bordi dhe Kolegjiumet e AKK-së kanë hartuar planet vjetore të punës me prioritete, angazhime dhe synime, duke u bazuar në agjendën legislative të Qeverisë Qendrore. Në këtë periudhë raportimi janë mbajtur nga 6 takime mesatarisht për secilin Kolegjium, pra, 18 takime të kryesive dhe 79 të Kolegjiumeve duke zhvilluar dhe konsoliduar nga së paku dy qëndrime për secilin Kolegjium. Përveç kësaj, AKK-ja ka marrë pjesë në takime të Komisioneve të ndryshme me qëllim dhënien e vërejtjeve dhe sugjerimeve si dhe shqyrtimin e projektligjeve gjatë shqyrtimit të legjislacionit.

Gjatë periudhës raportuese, në formën tjetër vlen të cekën edhe këto të arritura:

- Si një risi, përcaktimi i anëtarëve të Komisionit të Granteve nga ana e komunave u bë dy herë në takime të AKK-së, e ku morën pjesë ministra dhe sekretarë të përgjithshëm të ministrive.
- AKK-ja e ka përparuar raportin me Kuvendin e Kosovës, Komisionet Parlamentare dhe me deputetet e Kuvendit, duke e theksuar rolin e saj qendror në avokim për komunat. Përfaqësuesit e AKK pastaj morën pjesë në procesin e hartimit të projektligjeve si hapat përgatitore për ligjet përfundimtare.
- Duke u bazuar në lobimin e AKK-së, Ministria e Financave u zotua se nuk do të përgatisë asnjë dokument që prek komunat e që nuk do të jetë i kyçur edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Po ashtu edhe Ministria e Arsimit u zotua se shkollat nuk do të ndërtohen nga kjo Ministri por nga vetë komunat me që vlerësimi i komunave është më meritore për këtë çështje.
- Kërkesat e komunave me shumicë serbe për të adresuar problemet e tyre në AKK tregojnë se komunat me shumicë serbe jo vetëm që vazhdojnë të jenë anëtare në AKK-së por e shohin si mekanizëm adekuat për zgjidhjen e problemeve të tyre.
- Ndihma e AKK-së për lobim tek Qeveria qendrore për disa agjensione dhe institucione qeveritare në përcaktimin e agjendës legislative në nivelin qendror vlerëson ndikimin tonë.

Në funksion të përmbushjes së obligimeve statutores është mbajtur Kuvendi i Përgjithshëm Vjetor si dhe takimet e Këshillit të Kryetarëve dhe takimet e rregullta të Bordit të AKK-së. Segment tjetër është edhe plotësim-ndryshimi i Statutit të AKK-së përmes disa vendimeve të miratuara në Kuvendin e Përgjithshëm Vjetor të Asociacionit, të cilat janë bërë me kërkesën e Ministrisë së Admistratës Publike për të harmonizuar statutin me legjislacionin në fuqi për organizata joqeveritare. Këto ndryshime konsistojnë në: (a) Më parë ishte përfaqësimi politik- tani është rregulluar me vendime të Kuvendit të AKK-së, përfaqësimi i komunave në Kuvendin e AKK-së dhe përfaqësimi në Bordin e AKK-së; (b) Më parë ishte krijimi i fondeve dhe krijimi i institucioneve- tani është AKK-ja krijon mekanizma për ngritjen e kapaciteteve për autoritet komunale; (c) Më parë ishte Bordi i AKK-së,

pranon dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv – tani është Bordi i AKK-së, pranon dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv përmes rrugës së konkurrencës së hapur (konkursit), pas autorizimit të marrë nga Kuvendi. Poashtu gjatë këtij viti është draftuar Strategjia e AKK-së për vitin 2016-2020 me përfshirjen e gjitha palëve në proces të përpilimit.

AKK-ja ka vazhduar të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunat. Në këtë periudhë tek komunat janë dërguar mbi 135 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjigje, projektligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj. Uebfaqja e AKK-së vazhdon të mirëmbahet në baza ditore, në 'Facebook' postohen vazhdimisht të gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja dhe publikimi dymujor i Buletinit.

Në aspektin financiar, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 nga anëtarësia janë mbledhur € 65,000. Ku është realizuar 90 % i objektivit, duke mbledhur € 58,530. AKK-ja është e bindur që arrijë objektivin e saj të përgjithshëm vjetor prej € 130,000 deri në fund të vitit.

Bashkëpunimi me partnerë, AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, në realizimin e shumë projekteve që kanë përfutur komunat qoftë në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. SDC-ja si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së ka dhënë kontribut thelbësor si mbështetje për AKK-në. Bashkëpunime me projekte të ngjashme janë implementuar me DEMOS, GIZ, ACT/USAID-in, UNDP-in, OSBE-në. Po ashtu janë organizuar dy takime vjetor “Miqte e AKK-së” më partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët merren dhe punojnë në fushën e qeverisjes lokale.

Gjatë muajit Maj dhe Qershor, GIZ ka kontratuar dhe zhvilluar hulumtimin për të vlerësuar kënaqëshmërinë e autoriteteve lokale, partnerëve dhe institucioneve qeveritare me punën e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Ky hulumtim është bërë me 208 respondentë (34 kryetarë, 154 zyrtarë komunal, 5 partnerë dhe me 15 institucione qeveritare. Rezultatet tregojnë se 90 % të kryetarëve janë të shumë të kënaqur me punën e AKK-së kurse zyrtarët komunal e vlerësojnë AKK-në si një organizatë serioze dhe me ndikim. Në anën tjetër zyrtarët qeveritar vlerësojnë lartë punën dhe lobimin e AKK-së për anëtarët e vetë duke theksuar se për ministrië puna me AKK-në është rruga më e lehtë për t'i kuptuar sfidat dhe nevojat e komunave. Partnerët, tregojnë rezultatet se janë shumë të kënaqur me performacën e AKK-së dhe sidomos për një komunikimit të lehtë dhe përmbajtësor me AKK-në deri në adresimin e saktë të nevojave të komunave përballë komunitetit të donatorëve. Poashtu, rezultatet e hulumtimit tregojnë se komunat në bazë të vlerësimit (nga 1 deri në 10) me numra, 7.92 janë të kënaqur me punën e Bordit dhe 8.14 me punën e administratës së AKK-së.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AKK-së PËR VITIN 2015

Strukturat e AKK-së edhe në vitin 2015 kanë ndjekur objektivat të bazuar në Strategjinë dhe Planin Vjetor të AKK-së. Ndër objektivat kryesore për vitin 2015 ishin: Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të komunave përmes Lobimit dhe Avokimit, ofrimi i shërbimeve më të avancuara dhe përmirësimi i performancës së Komunave, funksionaliteti i strukturave të AKK-së, qëndrueshmëria financiare, bashkëpunimi me partnerët në pikëreferim të AKK-së, komunikime me komunat dhe performanca e administratës së AKK-së.

3. ZHVILLIMI E KONSOLIDIMI I POLITIKAVE (QËNDRIMEVE)

AKK përmes strukturave të saj Bordi, Këshilli i Kryetarëve, Kolegjiomet dhe Komisionet, konsolidoi qëndrimet e veta karshi institucioneve qendrore me synim zhvillimin e politikave të cilat do të ndihmonin në fuqizimin e rolit të vazhdueshëm të komunave.

Lobimi i AKK-së ka qenë i përqendruar në çështjet me prioritet për komunat: Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligji për partneritet publiko-privat, Ligji për pyjet, Ligji për tatimin në pronë, Ligji për pagat dhe Ligji për barazi gjinore.

Pra, konsolidimi i qëndrimeve dhe politikave ka rezultuar me intervenimet në Katalogun e vendeve të punës, faljen e borxheve nga Qeveria për kompanitë publike dhe personave fizik¹, pjesëmarrja aktive e AKK-së në KKZHE², inicimi i ndryshimeve në Ligjin për PPP³ dhe Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të tokës së paluajtshme komunale, takimi i AKK-së me Ministrin e MMPH-së për ligjin për ndërtimet pa leje.

Poashtu, pas reagimit të AKK-së, është ndërprerë procedimi për ndryshim e Udhëzimit Administrativ të MAPL nr.00/2014 për caktimin, ngarkesën dhe mbledhjen e pagesave për regjistrimin vjetor të automjeteve motorike në territorin e komunave, ku qëllimi i ndryshimit ka qenë heqja e kushtëzimit për regjistrim të automjeteve nga e cila taksë komunat përveç që kanë të hyra, po ashtu realizojnë edhe pagesa të shërbimeve publike. Heqja e kësaj pagese do të i kishte dëmtuar komunat në buxhetet e tyre në shumën rreth 3 milion euro.

AKK-ja ka takuar Bordin e Kolegjiut për prioritetet dhe planet vjetore të punës, bazuar edhe në agjenden legjislative të Qeverisë Qendrore e ku këtu hyn vazhdimi i punës në implementimin e Strategjive të Kolegjiut. Poashtu ishte edhe plotësim-ndryshimi i Statutit të AKK-së përmes disa vendimeve të miratuara në Kuvendin e Përgjithshëm Vjetor të Asociacionit, tërësisht në harmoni me legjislacionin në fuqi për organizata joqeveritare.

4. LOBIMI DHE AVOKIMI

4.1. Mbulimi i Deficitit

Konteksti

Pas lëshimit të Qarkores së Dytë Buxhetore për komunat për vitin 2016 nga Ministria e Financave, në analizat e bëra nga AKK (Kolegjiut për Buxhet dhe Financa), duke bërë krahasimet me buxhetin aktual të vitit 2015, ku për mostër është marrë muaji korrik 2015 për paga dhe mëditje është vërejtur që të gjitha komunat veç e veç janë në minus, kurse në total për paga dhe meditje të gjitha komunave iu mungojnë 10,874, 929.00 euro për vitin 2016. Ky deficit ishte mjaft shqetësues për të gjitha komunat.

Të Arriturat

Pas një lobimi të fuqishëm e të drejtëpërdrejtë nga ana e AKK-së në Ministrinë e Financave, përmes kërkesave me shkrim në këtë ministri për zgjidhjen e këtij problemi, dhe gjithashtu pas një presioni mediatik të bërë nga AKK, është arritur marrëveshja me Ministrinë e Financave për të mbuluar nga buxheti i qeverisë qendrore këtë deficit të paraparë për komunat për vitin 2016.

Impakti

Ky shkurtim buxhetor në komunat do të kishte ndikime mjaft të theksuara negative në procesin e mbarëvajtjes së funksionimit të komunave. Njëkohësisht ka qenë në rrezik të mbesin pa punë mbi 1500 arsimtarë në shkollat fillore dhe të mesme. Sigurimi i kësaj shume përmes AKK-së nga Ministria

¹ Falja e borxheve për qytetarët prej pas luftës deri në vitin 2008 (rekomandim i Kolegjiut për Buxhet dhe Financa që borxhet duhet falur me kusht që - nga vitin 2008 deri në fund të vitit 2014 duhet paguar të gjitha borxhet).

² Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik – ku është bërë prezantimi i qëndrimeve të komunave të Kosovës.

³ Me iniciativën e AKK-së përmes lobimit është arritur, inicimi i procedurave për ndryshim-plotësim të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat dhe Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

e Financave për komunat do të lehtësoj shumë komunat nga ngarkesat buxhetor ashtu kështu mjaft të kufizuara.

4.2. Inicimi i procedurave për plotësim-ndryshim të Ligjit për Partneritetin Publiko-Privat (PPP)

Konteksti

Ligji për PPP, i cili është në fuqi, ka kritere të njëjta për çdo vlerë të investimeve, e kjo iu ka humbur shumë kohë komunave deri në miratimin nga niveli qendror për realizimin e një projekti me PPP. Komunat shumë pak kanë realizuar projekte me PPP, andaj ka ardhur si kërkesë e komunave se ky ligj duhet ndryshuar sidomos në afate dhe në procedura, së paku për projektet deri në 2 milion euro investime.

Të arriturat

Përmes takimeve të AKK-së me Ministrinë e Financave respektivisht Departamentitn për Partneritet Publiko Privat është arritur marrrëveshja që në procesin e ndryshimit të ligjit për PPP, AKK të jetë pjesë e Komisionit, ku komunat do të kenë mundësi të ndikojnë me qëndrimet e tyre për të përfituar nga miratimi i Ligjit të ri për PPP, përmes thjeshtëzimit në procedurat e përzgjedhjes së partnerit privat për projekte më të vogla komunale. Poashtu një arritje tjetër do të jetë edhe lejimi i mundësisë që për projekte specifike komunale, përzgjedhja e partnerit privat të bëhet pa kaluar nëpër procedurat e para-përzgjedhjes. Si dhe komunat do të kenë mundësinë e përfshirjes së projekteve komunale për të cilat investimi i paraparë nga partneri privat nuk e kalon shumën prej 2 milion euro.

Impakti

Aprovimi i këtij ligji, pritet të ketë efekt direk në Zhvillimin Ekonomik Lokal përmes shkurtimit të procedurave për investime duke krijuar një ambient të përshtatshëm për investitorët dhe si rrjedhojë do të ndikoj në zbutjen e papunësisë. Thjeshtësimi i procedurave e shkurtimi i afateve iu jep me shumë kohë dhe mundësi komunave për zhvillim të projekteve me partneritet publiko-privat.

4.3. Inicimi të procedurave për ndryshim-plotësim të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzimin dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

Konteksti

Prona e paluajtshme komunale është e një rëndësie të veçantë për stimulimin e zhvillimit ekonomik në nivel komunal dhe ndër të paktat nga pasuritë me të cilat menaxhohet në nivel lokal. Legjislacioni në fuqi në vendin tonë edhe pse është siguruar që të ketë decentralizim nga niveli qendror në atë lokal, ky kryesisht ka ndodhë në fushën e menaxhimit të financave publike dhe në menaxhimin e pronave. Mirëpo, sa i përket çështjeve të tërheqjes së investimve të gjitha instrumentet ligjor akoma mbeten në nivel qendror dhe Komunat janë të hendikepuara në aspektin e tërheqjes së investimve apo krijimin e kushteve për investitorë.

Të arriturat

Kjo është arritur pas përpjekjeve të vazhdueshme të AKK-së në të gjithë mekanizmat institucional, edhe përkundër mos gatishmërisë së MAPL-së, që ta fut në agjendën legjislativë për vitin 2016, plotësim-ndryshimin e këtij ligji, AKK-ja e arriti këtë për mes Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili Këshill obligoj MAPL-në që ta parasheh në agjendën legjislativë ndryshim-plotësimin e Ligjit në fjalë.

Impakti

Ndryshim-plotësimi i këtij ligji do të ketë ndikim të fuqishëm në mundësinë e dhënë për komunat për të menaxhuar me pronat e tyre në mënyrë më efikase me qëllim të gjenerimit të të hyrave dhe të zhvillimit të projekteve të cilat avancojnë zhvillimin ekonomik në komuna. Ky ligji do të eliminojë të

gjitha barrierat, burokracinë e panevojshme edhe afatet e gjata reth procedurave për dhënien së pronës komunale në shfrytëzim për investitorët potencial të huaj dhe vendor. Poashtu do të shkurtoj afatet administrative të aplikimit si dhe shkurtime të afateve të ankesave i dhe hapet mundësia e procedurës së negociimit direkt me investitorë të mëdhenj duke instaluar procedura të llogaridhënies në mes nivelit ekzekutiv dhe Kuvendit të Komunës. Njëkohësisht, garancioni bankar i cili do të këtë vlerën së paku 10% të nivelit të investimit të propozuar, në rast të mos përmbushjes së obligimeve kontraktuale autoriteti komunal gëzon të drejtën e ekzekutimit të këij garancioni duke mbrojtur interesin publik.

4.4. Hartimi i KATALOG-ut të vendeve të punës në shërbyesit civil të nivelit lokal

Konteksti

Kosova deri tani nuk ka pasur katalog të vendeve të punës për shërbyesit civil as të nivelit qendror as të nivelit lokal. Është vlerësuar se për të hyrë në procesin e reformës së administratës publike duhet paraprakisht të hartohet katalogu i vendeve të punës. Ky katalog duhet përfshirë të gjitha pozitat e punës për të gjitha institucionet me qëllim që të mos ketë diferencime mes nivelit qendror dhe lokal për pozita të njëjta dhe me koeficienta të ndryshëm. Poashtu kjo ka shkaktur jo harmonizim në pozitat e karrierës si mes zyrtarëve me pozita të njëjta mes nivelit qendror dhe lokal ashtu edhe mes zyrtarëve me pozita të njëjta në komuna të ndryshme.

Të arriturat

Model dokumenti i hartuar nga AKK-ja, iu ka lehtësuar në masë të madhe punën të gjitha komunave, poashtu janë koordinuar aktivitetet mes komunave dhe nivelit qendror ngase bashkarisht janë evidentuar pozitat që i kanë munguar katalogut të hartuar nga niveli qendror. Propozimi i AKK-së për t'u shtuar mbi 30 pozita të reja të nivelit lokal (të cilat ekzistojnë në nivelin lokal por nuk i ka paraparë ky dokument), është pranuar nga niveli qendror dhe janë marrë parasysh edhe gradat e propozuar me koeficientët.

Impakti

Mospërfshirja e shumë pozitave të punës në nivel lokal, krijoi mjaft amulli tek komunat, shqetësime te zyrtarët lokal se do të mbesin pa punë dhe ne opinion u kuptua se ky katalog do të jetë më i favorshëm për nivelin qendror se sa lokal. Andaj AKK-ja mori iniciativën, formoi grupin punues edhe hartoj modelin e katalogut për shërbyesin civil të nivelit lokal. Ky katalog i përfshiu të gjitha pozitat e punës, u kategorizuan sipas kriterëve dhe iu përcaktuan koeficientët.

4.5. Falja e borxheve

Konteksti

Pasi Qeveria e Kosovës shpali idenë për faljen e borxheve të të gjithë qytetarëve dhe biznesëve nga pas lufta e deri në fund në vitin 2008, AKK-ja zhvilloi aktivitete me mekanizmat përkatës dhe doli me qëndrim se kjo iniciativë e trajtuar nga Qeveria është një veprim shumë i arsyeshëm, e cila nuk ka për qëllim të amnistojë ata që nuk i kanë përmbush obligimet, qoftë obligime tatimore, qoftë obligimet për shërbimet publike, por në rend të parë ka të bëjë me politikat e Qeverisë, në mënyrë që të pastrohen llogaritë e kompanive publike dhe llogaritë e buxhetit.

Të arriturat

AKK-ja përmes rekomandimeve arriti të kanalizojë kërkesën e saj tek autoritet qendrorë (Ministria e Financave) deri në futjen përfundimtare në "Projektligjin për Faljen e Borxheve Publike" ku kërkohet që Qeveria e Kosovës t'a kushtëzoj faljen e borxheve ndaj komunave me pagesën e obligimeve të krijuara pas vitit 2008, në mënyrë që të zbuten efektet negative të këtij vendimi për komunat në fushën e financave lokale.

Impakti

Vendimi i tillë pa lobimin e AKK-së do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në komuna sa i përket zvogëlimit së të hyrave vetanake, ku do të kishte efekt negativ në mos pagesën e mëtutjeshme të tatimit në pronë, tek ajo pjesë e popullatës e cila ka qenë e rregullt në shlyerjen e obligimeve të deritanishme ndaj komunës. Impakti tjetër ka të bëjë po ashtu edhe me masat për rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe stimulimit të tyre apo nxitjes së tyre që ata t'i përmbushin obligimet tatimore dhe obligimet tjera ndaj shërbimeve publike, për periudhën prej 1 janarit 2009 dhe deri më tani. Në anën tjetër, falja e borxheve sipas këtij ligji do të krijojë një moment të ri që do t'i shërbejë për ngritjen e disiplinës së përgjithshme të personave fizik dhe juridik në Republikën e Kosovës karshi obligimeve tyre publike.

4.6. Planifikimi Hapësinor

Kontesti

Me kërkesë të AKK-së është organizuar takimi me Ministrin e Ministrisë për Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, me qëllim të sqarimit të disa çështjeve të ngritura nga AKK si zbatimi dhe revidimi i ligjit për legalizim të ndërtimeve pa leje si dhe çështjet të cilat prekin punën e përditshme të planifikimit hapësinor në komuna. Çështja është adresuar edhe përmes pyetjeve konkrete nga AKK drejtuar ministrisë për problemet që i kanë me Planet Rregulluese Urbane të skaduara, revidimi tyre, hartimi i planeve të hollësishme, kundërthëniet në mes planeve urbane dhe atyre zhvillimore komunale, plani zhvillimor urban, plani zhvillimor komunal, legalizimi, ligji ndërtimit, Parku kombëtar 'Bjeshkët e Nemuna'.

Të arriturat

Departamenti Ligjor dhe Departamenti Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në MMPH, kanë dhënë përgjigje në këto kërkesa të parashtruara nga AKK, duke sqaruar veprimet të cilat komunat mund të ndërmarrin bazuar në ligjet ekzistuese. Gjithashtu pas paraqitjes së vështirësive nga komunat në zbatimin e Ligjit për ndërtimet pa leje, është iniciuar ndryshimi i këtij ligji dhe AKK do të jetë pjesë e procesit për ndryshimin e këtij ligji.

Impakti

Janë nxjerrë shumë mësimë përmes zbatimit të ligjit ekzistues dhe këto mësimë do të kontribuojnë për një program edhe më të suksesshëm të legalizimit nëse ligji ri-hartohet. Qytetarët të cilëve u ka ikur afati për t'u regjistruar në Regjistër mund të aplikojnë për legalizim. Komunat mund të procedojnë të 350.000 ndërtimeve pa leje më shpejtë dhe në mënyrë më efikase. Pra, ndërtime të caktuara që më parë ishin përjashtuar nga legalizimi tash mund të merren parasysh nën rrethana të caktuara. Dhe afatet për procedimin e ndërtimeve të shumta pa leje do të zgjaten. Ndryshimi i këtij Ligji në bazë të nevojave dhe rekomandimeve nga komunat do të ketë ndikim ngritjen e të hyrave vetanake për komunat. Gjithashtu sqarimet e ofruara nga MMPH për aspektet e tjera të ngritura nga AKK do të lehtësojë mbarëvajtjen në fushën rregullative.

5. PUNA E KOLEGJIMEVE PËR SHËRBIME NDAJ KOMUNAVE

Kolegjiomet e AKK-së në planet vjetore të tyre kanë përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet e punës në identifikimin e temave me interes në zhvillimin e aktiviteteve me interes të pushtetit lokal duke u përqendruar në përmirësimin e shërbimeve komunale në interes të qytetarëve. Gjatë këtij viti janë mbajtur nga 6 takime mesatarisht nga secili Kolegjiom, ose 18 takime të Kryesive dhe 79 të Kolegjiomeve. Në këtë proces Kolegjiomet kanë zhvilluar dhe konsoliduar nga së paku dy qëndrime në aktivitetet e tyre të punës, si dhe në vazhdimësi janë mbajtur takime të Komisioneve të ndryshme me qëllim dhënien e vërejtjeve dhe sugjerimeve në shqyrtim të projektligjeve nga niveli qendror gjatë shqyrtimit të legjislacionit. Disa prej rezultateve (më poshtë) të cilat kanë arritur Kolegjiomet përmes

angazhimit me punën e tyre me anë të analizës dhe dhënies së rekomandimeve konkrete kanë arritur ndryshimin dhe përmirësimin e shërbimeve të AKK-së ndaj komunave.

Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa – vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për faljen e borxheve, me përfshirjen edhe të borxheve nga mospagesa e tatimit në pronë deri në vitin 2008 si dhe futja e rekomandimeve tek Ministria e Financave në “Projektligjin për Faljen e Borxheve Publike” që të kushtëzojë faljen e borxheve ndaj komunave me pagesën e detyrimeve pas vitit 2008 në zbutjen e efekteve negative të këto vendimi për komunat në fushën e financave lokale.

Kolegjiumi për Inspeksion – pavarësisht nga centralizimi i kompetencave të inspektorëve përmes Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut i cili ende nuk ka gjetur zbatim në teren dhe ka shkatuar çrregullim dhe huti tek qytetarët në ofrimin e këtyre shërbimeve, Kolegjiumi për Inspeksion në bashkëpunim me DEMOS dhe konsultim të vazhdueshëm me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ka ndërmarrë nismën për ndryshim të këtij ligji përmes një analize të përfunduar i cila ka për synim evidentimin e sfidave në funksionimin e mbikëqyrjes së tregut si dhe gjetjen e një modeli funksional në tejkalimin e kësaj situate.

Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor – Duke u ballafaquar me mospagesën e procesit të trajtimit të ndërtimeve pa leje, Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor inicoi ndryshimin e këtij ligji si një qëndrim unik i të gjitha komunave duke dhënë arsytimin dhe nevojën urgjente në tejkalimin e kësaj situate ku edhe po punon në mënyrë intensive në gjetjen e alternativave në tejkalimin e kësaj situate përmes grupeve punuese të themeluara me vendim të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik – Kanë filluar procedurat e nevojshme për ndryshimin e Ligjit për Partneritet Publiko Privat me synim të qartë zvogëlimin e procedurave në shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve PPP në mënyrë që të jetë sa më përmbajtjesor në funksion të zhvillimit ekonomik lokal.

Kolegjiumi për Integritet Evropian – me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Kosova ka lidhur marrëveshjen e parë gjithëpërfshirëse me Bashkimin Evropian duke u zotuar për reforma gjithëpërfshirëse dhe përafrimin e legjislacionit me BE-së në sektorë të ndryshëm. Kolegjiumi i zyrtarëve komunal për Integritet Evropian në bashkëpunim me Ministrinë e Integritetit dhe Administrimit të Pushtetit Lokal po punon në bashkëpunimin e aktiviteteve në kuadër të agjendës evropiane me qëllim informimin dhe diskutimin për çështjet që ndërlidhen me procesin e integritetit evropian në komuna si dhe rritjen e koordinimit midis institucioneve qëndrore dhe lokale në realizimin e programit për fushën e integriteteve evropiane.

Kolegjiumi për Shërbime Publike – përmes suksesit të projektit “Skema Beacon” i cili kishte për qëllim promovimin e praktikave të mira komunale në fushën e shërbimeve komunale, që arriti efektin e motivimit për sukseset e identifikuara, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në të gjitha komunat si dhe rritjen e konkurrencës së ideve dhe sukseseve e të cilat u manifestuan në identifikimin dhe promovimin e inovacioneve në nivelin lokal.

6. QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE E AKK-së

6.1. Konteksti i shkurtër

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka si synim të vazhdueshëm ndërtimin e një sistemi të qëndrueshmërisë financiare që garanton ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe statusore të saj. Edhe pse AKK që nga themelimi e deri sot është përballur më vështirësi dhe sfida të shumta të cilat kanë

reflektuar direkt në qëndrueshmërinë financiare të saj. Megjithëkëtë, AKK ka arritur që të krijoj jo vetëm një trend pozitiv në krijimin e qëndrueshmërisë financiare, por edhe në ndryshimin e perceptimit të komunave ndaj AKK-së duke rezultuar më ndërtimin e raporteve kontraktuale dhe mirëbesuese të dyanshme. Kjo është dëshmuar edhe në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së që u mbajt në muajin Mars 2014 përmes pjesëmarrjes masive të komunave dhe anëtarësimit të komunave më shumicë serbe dhe minoriteteve tjera. Ky mirëbesim po vazhdon edhe në vitin 2015.

6.2. Të arriturat gjatë vitit 2015

Objektivi i paraparë në buxhetin e AKK-së lidhur me të hyrat nga anëtarësia për vitin 2015, ka qenë 130,000 €. Brenda periudhës referuese AKK ka realizuar 91 % të objektivit të paraparë, duke mbledhur 117,710€. Arsyeya e mos plotësisimit 100 % të objektivit për periudhën referuese lidhet me disa vështirësi më të cilat janë përballë Komunat me mungesë të buxhetit në disa kategori, dhe nevojës për prioritizimin e shpenzimeve për vitin 2015. Si rezultat, një pjesë e Komunave janë zotuar se obligimet e tyre të mbetura për vitin 2015 do t'i realizojnë në fillim të vitit 2016. Nëse marrim parasysh arsyet e mësipërme, atëherë mund të konstatojmë se AKK është duke ruajtur trendin pozitiv në të hyrat nga anëtarësia dhe për më tepër ka tendenca që ky trend të bëhet edhe me i qëndrueshëm në të ardhmen.

Si suksese të arritura në kuadër të këtij objektivi mund të konsiderohet vazhdimi i aktiviteteve lobuese që kanë për qëllim nxitjen e Komunave në kryerjen e obligimeve financiare të AKK-së. Ky lobim është bërë përmes mekanizmave të AKK-së, si Kolegji i profesionalëve dhe në veçanti përmes Këshillit të Kryetarëve si një mekanizëm që mbledh të gjithë kryetarët e Komunave.

AKK vazhdon bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me projektin DEMOS për të ndikuar tek komunat të cilat përfitojnë nga grantet e këtij projekti lidhur me kryerjen e pagesës së anëtarësisë ndaj AKK-së. Bashkëpunimi i AKK-së me partnerët e ndryshëm në këtë drejtim do të ketë një impakt shumë pozitiv në qëndrueshmërinë financiare të AKK-së. Vlen të theksohet se AKK, ka zgjeruar projektet e saj në dobi të Komunave edhe me organizatën Gjermane GIZ, projekte këto që kanë pasur efekt edhe në sensibilizimin e Komunave në kryerjen e obligimeve ndaj AKK-së.

Brenda periudhës referuese, Bordi i AKK-së, përkatësisht Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv kanë vazhduar vizitat e rregullta në Komuna përmes të cilave kanë dëgjuar shqetësimet e Komunave për problemet më të cilat ballafaqohen ato. Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së kanë shprehur gatishmërinë e AKK-së për të adresuar të gjitha brengat e Komunave në instancat përkatëse. Këto vizita kanë shërbyer si një mundësi e mirë për të sqaruar edhe pozicionin financiar të AKK-së si dhe nevojën për një qëndrueshmëri financiare të vazhdueshme.

6.3. Financimi nga palët e treta

Financimi nga palët e treta nënkupton grantet e realizuara nga AKK përveç atyre të realizuara nga programi i financuar nga SDC. Në këtë drejtim AKK për vitin 2015 ka paraparë një buxhet në total prej €136,885 nga organizata të ndryshme financuese, si NALAS, COUNCIL OF EUROPE, GIZ. Në periudhën referuese, AKK ka arritur të realizoj një pjesë të grantëve të parapara, përkatësisht në këtë periudhë AKK ka nënshkruar kontratë me GIZ, në shumë prej € 96,400. Me Council of Europe, në shumë prej € 4,590 dhe me NALAS, në shumë prej € 10,300. Totali i granteve nga kontratat e nënshkrura për periudhën referuese është € 111,290, ose 82 % e totalit të granteve të parapara për vitin 2015.

7. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT

Konteksti i angazhimeve të një mori organizatave në pushtetin lokal në Kosovë determinon dhe inkurajon Asociacionin e Komunave të Kosovës për një partneritet me këto organizata me të cilat i bashkërendon aktivitetet ngase ndërlidhen punët e përbashkëta me ta. Bashkëpunimi me partnerë AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, në realizimin e shumë projekteve që kanë përfituar komunat

qoftë në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. Poashtu ky partneritet ka ndikuar edhe në ngritjen e performancës së komunave, ngritjen e kapaciteteve, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme, plotësimin e mungesave të dokumenteve të nevojshme, bashkëpunimin mes komunave dhe bashkëpunimin mes komunave dhe organizatave të ndryshme etj.

SDC - Si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së jep kontribut thelbësor si mbështetje institucionale për AKK-në. Programi i financuar nga SDC-ja i jep më shumë hapësirë veprimi, mbulimit të aktiviteteve të AKK-së varësisht nga koha dhe nevoja për lobim për dallim nga projekte e organizatave tjera. Programi mbështetës i financave nga SDC është gjithëpërfshirës në aktivitetet e AKK-së dhe i integruar me buxhetin bazë.

Miqtë e AKK-së / takimi vjetor - më partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët merren dhe punojnë në fushën e qeverisjes lokale. Miqtë e AKK-së po funksionon si një mekanizëm shumë i rëndësishëm në bashkërendimin e aktiviteteve mes institucioneve lokale dhe organizatave partnere të tyre. Vlen të theksohet roli kryesor që luan AKK-ja në këtë koordinim të takimit dhe aktiviteteve të tyre. Sivjet në këtë forum u debatua edhe drafti i Strategjisë së AKK-së 2016-2020.

Kurse partneriteti i AKK-së me projekte të ndryshme ndërlihet në këto aktivitete:

- Bashkëpunim me projektin e Bashkimit Evropian “Mbështetje Ministrisë së Financave”, projekt i implementuar nga GIZ në partneritet me Ernst&Young, në prezentim të Doracaku “Kodimi i Programeve”. Poashtu vizitë studimore në Mal të Zi dhe në Shqipëri në temat si tatimi në prone, taksa e ndërtimit dhe tatimet tjera.
- Përgatitja dhe publikimi i Doracakut “Integrimi gjinor në Planifikimin Hapësinor” - Një qasje hap pas hapi për komunat.
- Në bashkëpunim me OSBE-në është botuar doracaku për komunat - “Model-rregulloret komunale” në tri gjuhët dhe po iu shpërndahet të gjitha komunave.
- Analiza në bashkëpunim me HELVETAS sa i përket punës dhe rikthimit të kompetencave tek autoriteti lokal të Inspektorëve të Tregut.
- Në bashkëpunim ndërinstitucional në mes të GIZ-MAPL-AKK, u organizua punëtorja me temë “Sfidat dhe të arriturat e komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane”.
- Në mbështetje të Agjencisë për Investime dhe përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), u organizua konferenca me qëllim prezantimin rezultatet e raportit të vlerësimit të konkureshmërisë në komuna i cili është përpiluar nga Kosovo SME Promotion Programe (KOSME).
- Në bashkëpunim me projektin JICA /Japan International Cooperation Agency u organizua punëtorja për mbështetje institucionale në menaxhimin e mbeturinave në Kosovë, me qëllim prezantimin e diskutimin e përvojave të mira nga komunat si dhe fuqizimin e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit.
- Në mbështetje të GIZ është zbatuar programi i praktikave të mira “Skema Beacon” ku aplikuan 19 komuna me 22 aplikacione. Përmes procesit të konkurimit janë përzgjedhur: Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëra - Komuna e Gjilanit, Task Forca Komunale për Mjedis - Komuna e Gjakovës dhe Ndriçimi Publik - Komuna e Ferizajit. Kurse faza e shpërndarjes së praktikave është bërë në tetor/nëntor.
- AKK-ja në bashkëpunim me GIZ ka ndërtuar sinergjitë në projektin lidhur me shkëmbimin e praktikave më të mira komunale, pastaj me GIZ/NALAS lidhur me Eficiencën e Energjisë, dhe disa aktivitetet të përbashkëta me DEMOS-in, ACT / USAID-in, UNDP-in.
- Në bashkëpunim me Projektin DEMOS dhe Agjencionin për Barazi Gjinore është hartuar “Model-rregullorja për përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtareve për barazi gjinore, në ministri dhe komuna”.

8. AKTIVITETE DHE SHËRBIME TJERA

8.1. Përgatitja e Strategjisë së AKK-së 2016-2020

Bordi i AKK-së ka miratuar vendimin dhe ka themeluar Komitetin Planifikues i përbërë nga tre kryetar për procesin dhe përgatitjen e Strategjisë së Asociacionit për vitet 2016-2020. Ekzekutivi i AKK-së ka mbajtur dy takime ku është bërë edhe analiza e brendshme e strukturës së AKK-së, përfshirë fuqitë dhe dobësitë e AKK-së, si dhe është bërë analiza e faktorëve të jashtëm të cilët mund të kenë ndikim në punën dhe aktivitetet e AKK-së dhe komunave në periudhën e ardhshme planifikuese. Procesi i hartimit të strategjisë ka vazhduar me përfshirjen e mekanizmave tjerë të AKK-së, si: dërgimi i një pyetësori të gjithë anëtarët e AKK-së, procesi ka vazhduar me diskutimet me Kolegjiunet profesionale të AKK-së, Këshilli i Kryetarëve, Bordi i AKK-së si dhe miqtë e AKK-së nga komuniteti i donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare, partnere të AKK-së

8.2. Funkcionimi i strukturave të AKK-së

Me angazhimin e vetë, AKK-ja, gjatë vitit 2015 ka përmbushur obligimet statutare të funksionalitetit të strukturave të veta. Janë organizuar disa takime të Këshillit të Kryetarëve, të cilin organ e kemi fuqizuar edhe më tutje si dhe është mbajtur takimi i Kuvendit të Përgjithshëm, i cili veç shqyrtimit të raporteve vjetore ka bërë edhe plotësim ndryshimin e Statutit të AKK-së të cilit i kanë parapri disa takime nga Bordi dhe harmonizimi i propozim ndryshimeve me legjislacionin në fuqi.

8.3. Komunikimi

Asociacioni i Komunave të Kosovës vazhdoi edhe këtë vit të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunat. Në këtë periudhë tek komunat janë dërguar mbi 135 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjegjje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj. Duke zhvilluar transparencën, në uebfaqen e AKK-së janë vendosur vazhdimisht gjitha publikimet dhe broshurat e përgatitura nga AKK-ja dhe disa nga partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë derisa përmes zyrtarit për TI mirëmban në baza ditore uebfaqen e vetë. Po ashtu me nxjerrjen e publikimit peroidik, të vetmin për pushtetin lokal, AKK-ja përgatit, shtyp dhe shpërndan Buletinin e vetë në baza dymujore, kështu që gjatë këtij viti janë përgatitur, publikuar dhe shpërndarë gjashtë Buletine. Poashtu AKK-ja ka punuar në forcimin e imazhit të vetë qoftë edhe përmes produkteve identifikuese. Në këtë drejtim është edhe faqja sociale e AKK-së në 'Facebook' ku aty postohen gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja. Një rol i madh në këtë drejtim është bërë gjatë takimeve të Kolegjiuneve, Konferencave e seminareve të ndryshme, takime të ndryshme me nivelin qendror etj.

8.4 Shërbime dhe arritje tjera

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është arritur pajtimi që shkollat të ndërtohen nga komunat qoftë edhe në rastet kur granti është siguruar nga MASHT-i. Kjo është një arritje tjerë derisa ishte kërkesë e kahmotshme e komunave, meqë askush si komunat nuk e vlerëson dhe monitorin proceset e tillë në dobi të publikut.

AKK-ja ka arritur poashtu të arsyetoj dhe të fus në projektligj që kryetari i komunës të marrë 70% të pages bazë të kryetarit pas një viti nëse kryetari nuk ka një punë tjetër. Kryetari i Komunës në këtë drejtim ka hyrë në kategori me zëvendëskryeministrin, ministrin dhe deputetin e Kuvendit të Kosovës.

AKK-ja këtë vit ka bërë edhe disa lobime të veçanta për ministri dhe institucione qendrore me kërkesën e tyre tek ne duke vlerësuar ndikimin tonë në përcaktimin e agjendës legjislative në nivelin

qendror. Rasti i parë ishte me çështjet për barazi gjinore për hartimin e “Rregullores për detyrat dhe përgjegjësitë e zytarëve përkatës për barazi gjinore në Ministri dhe Komuna”, kërkuar nga Agjensioni për Barazi Gjinore. Rasti tjetër ishte rasti i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Mjedis e cila ka kërkuar bashkëpunim dhe lobim tek Kryeminsitria për futjen në agjendë për amandamentimin e Ligjit për Ndërtimet pa leje.

Përcaktimi i anëtarëve të Komisionit të Granteve nga ana e komunave u bë në një takim të AKK-së, e ku morën pjesë katër Ministra dhe dy Sekretar të Përgjithshëm të Ministrive. Kjo është bërë njëherë për vitin 2015 dhe në fund të vitit është bërë kjo përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Granteve për vitin 2016. Është hera e parë që kjo bëhet në takimet e organizuara nga ana e AKK-së dhe paraqet një fuqizim të rolit dhe rëndësisë që ka Asociacioni i Komunave. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se Ministri i Financave është zotuar se nuk do të përgatitet asnjë dokument që prek komunat e që nuk do të jetë i kyqur edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Raporti përparuar me Kuvendin e Kosovës si me Komisionet Parlamentare ashtu edhe me struktura tjera dhe me vetë deputetet e Kuvendit ku vërehet një rol i fuqizuar i AKK-së. Poashtu pjesëmarrja e përfaqësuesve të AKK-së në hartimin e Koncept-Dokumentit të Projekt-Ligjeve si para-nisje për hartimin e një Ligji.

Komunat me shumicë serbe kanë pasur disa kërkesa për organizimin e takimeve të strukturave të AKK-së për të trajtuar çështje të veçanta. Rasti më i fundit ishte kërkesa e Komunës së Graçanicës për organizimin e një takimi të Këshillit të Kryetarëve për të trajtuar dukurinë e qenëve endacak dhe për të parë mundësinë e bashkëpunimit me komunat fqinje në zbutjen dhe eliminimin e këtij problemi. Çështje tjetër e ngritur nga komunat me shumicë serbe është edhe projekt ligji për regjistrimin e popullatës serbe në komunat në të cilat procesi i regjistrimit të popullatës nuk është përkrahur në vitin 2011. Përmes AKK-së këto komuna kanë kërkuar që ky projekt ligj t’i regjistrojë edhe popullatën serbe në komunat e tjera përpos atyre në pjesën veriore të Kosovës. Këto kërkesa tregojnë se komunat me shumicë serbe jo vetëm që vazhdojnë të jenë anëtare në AKK-së por e shohin si mekanizëm adekuat për zgjidhjen e problemeve të tyre.